

PROCES-VERBAL Nr. 1

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje vegla pune për punonjësit e terrenit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV 42652000-1 Mjete elektromekanike dore

Kodi CPV 42662100-5 Pajisje elektrike saldimi

Kodi CPV 44511500-0 Sharra dore

Kodi CPV 44512000-2 Mjete te ndryshme dore

Kodi CPV 44512200-4 Pinca

Kodi CPV 44512800-0 Kaçavida

VLERA E FONDIT LIMIT: 4, 052,300 (katër milion e pesedhjetë e dy mijë e treqind) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH, Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Formulari i Vetëdeklarimit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2026 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9 të DST-ve.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore mbështetur në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenit 43 pika 2, germa c) e 3, nenit

55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr. 26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.”

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo më të vogël se 15% të vlerës së fondit limit.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 15 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55 pika 4, gërma ”b” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar)

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike për secilin artikull, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të mallrave sipas dokumenteve të tenderit.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon të verifikojë në mënyrë të besueshme përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.4.2 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë garancie në të cilën të jenë të përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi. Periudha e garancisë teknike do të fillojë nga data e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi dhe do të jetë 1 (një) vit.

2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma ”a” dhe pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar,

2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi, do të jenë të papërdorura më parë (të reja) dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për skualifikim, si dhe do të veprohet konform parashikimeve të LPP.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet janë si më poshtë:

TRAPANO ELEKTRIKE DORE

Ilustrimi

(Ilustrimi është orientues)



Pershkrimi

Trapani elektrik i dores ka keto karakteristika kryesore:

- Shpejtesi e regullueshme me celes me dy pozicione
- 3 menyra zgjedhjeje: cpim, cekan cpim,
- 2 doreza: mbajtese dhe komanduse
- Madhesia e mandrinos metalike 13 mm
- Te kete celes reversi rrotullimesh
- Te kete markimin CE
- Kablli fleksibel i ushqimit

Te dhena teknike

- Tesioni ushqimit: 220 V AC
- Fuqia 1050 W (ose sipas kerkeses)
- Shpejtesia I/II :0-1200/0 3200rot/min
- Diametri max i Puntos per beton 20 mm
- Diametri max i Puntos per celik 16 mm
- Gjatesia e kabllit 2m
- Aksesoret perkates per te tre menyrat e zgjedhjes
- Afati i garancise 1 vit

Shkalle metalike me tre hapje

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Shkalla duhet te plotesoje standartin CE

Shkallet duhet te jene ne perputhje me standartin SSH EN 131

Shkalla eshte e perbere me material alumini.

- Shkalla duhet te kete rezistence te larte mekanike ne perkulje dhe ne perdredhje. Kollonat anesore jane te perbera me material alumini me seksion drejtkendor. Pjeset horizontale mbeshtetese e kembeve jane aljzh alumini me seksion katror. Pjeset horizontale prodhohen me damare per te mos lejuar rreshqitjen.
- Per te rritur sigurine gjate punes shkalla duhet te kete bllokim mekanik
- Pjesa mbeshtetese ne toke edhe siper duhet te jete e veshur me material kunder rreshqitjes me qendrueshmeri te larte mekanike dhe te jete e qendrueshme ndaj agjenteve atmosferike UV.
- Shkalla duhet te jete e lehte per tu transportuar. Gjeresia e shkalles duhet te jete 48 cm. Ngarkesa per hapjen maksimale >120Kg
- Numri i seksioneve 3 (tre hapje)
- Afati i garancise 1 vit

MOTOSHARRE

Ilustrimi

(Ilustrimi eshte orientues)



Pershkrimi

Motosharra eshte nje paisje dore qe sherben per te prere dru dhe shkurre te ndryshme gjate pastrimit te trase se se linjes.

Ajo eshte nje sharre me zinxhir qe vihet ne levizje nepermjet nje motori me djegje te brendeshme. Forma e saj duhet te jete praktike ne perdorim. Materialet perberese duhet te jene me cilesi te larte, te qendrueshme mekanikisht. Forma e dorezave mbajtese duhet te jete e tille qe te siguroje perdorim komod. Gjate kohes se trasportit udhezuesi dhe zinxhiri kane kellef mbrojtjes.

Karakteristikat

- | | |
|--------------------------|-----------------|
| ✓ Tipi | Share me benzin |
| ✓ Pjesa aktive e prerjes | 50 cm |

Motori (Engine)	Tipi		
	Me nje cilinder, me dykohe, ftohje me ajertesforcuar, anti reshqitje (single cylinder, 2-stroke, air-forced cooling, anti slip)	Me nje cilinder, me dykohe, ftohje me ajertesforcuar, anti reshqitje (single cylinder, 2-stroke, air-forced cooling, anti slip)	Me nje cilinder, me dykohe, ftohje me ajertesforcuar, anti reshqitje (single cylinder, 2-stroke, air-forced cooling, anti slip)
Fuqiamax.(Max power)	2.4kw/11000rpm	1.7kw/8000rpm	0.9kw/8000rpm
Zhvendosja(Displacement)	58cc	45cc	25.4cc
Raportiperzjerjeskarburantit (Fuel mixture ratio)	Gasoline:oil—25:1	Gasoline:oil—25:1	Gasoline:oil—25:1
Serbatorikarburantit (Fuel tank)	550ml	550ml	230ml
Serbatorivajit (Oil tank)	260ml	260ml	160ml
Diametric max. I			
Pompa(Oil pump)	automatic	automatic	automatic

Shenim: Me qene se termat jane teknike dhe perkthimi i tyre mund te mos pershtatet, per baze do te meret emertimi ne anglisht.

Paketimi : Paketim standart

Afati i garancise 1 vit

Aparat Saldimi

Ilustrimi

(Ilustrimi eshte orientues)



Aparati i saldimit do të perdoret per saldimin me hark elektrik. Aparati duhet te jete i teknologjise INVERTER MMA dhe te kete :

- 1- Matesi i rrymes se saldimit
- 2- Butoni rregullimit te rrymes se harkut
- 3- Butoni rregullimit te rrymes se saldimit

Bashkë me aparatn duhet të jenë dhe aksesoret e mëposhtem:

- Valixhja mbajtëse

- Kablli i saldimit dhe mbajtësja e elektrodës
- Kablli i kthimit dhe dara e tokës

Specifikimet teknike:

Rryma e saldimit 20-300 A
 Tensioni hyrjes AC 380V 50 Hz
 Perdoren elektroda saldimiti 1,6 deri 5 mm

Te kete markimin CE

Afati i garancise 1 vit

PRESE HIDRAULIKE KAPIKORDASH 16-300 mm²

Ilustrim



Pershkrimi

Kjo prese sherben dhe duhet per presimin e kapikordave te izoluara dhe te pa izoluara.

- | | |
|--|---------|
| ○ Diapazoni presimit per bashkuse percjellsa bakri mm ² | 16-300 |
| ○ Diapazoni presimit per kapikorda kablli mm ² | 16-300 |
| ○ Gjatesia / Pesha (orientuese) mm / kg | 540 / 4 |

Funksioni mekanik siguron operatione te sigurta dhe te menaxhueshme ne kushte te ndryshme atmosferike.

- Precision inxhiniering, qe do te thote force te larte presuese me pak force fizike
- Avancim i shpejte qe ndihmon ne qenderzimin e pjeseve qe bashkohen
- Shtrengim te sigurte per nje presim pa probleme
- Mundesi te c'bllokimit ne rast te nje funksionimi jo te regullt
- Game te plote te setit te presave konform standarteve
- Per kapikorda kablli tubolare nga 16-300 mm²
- Per bashkuse percjellsa bakri nga 16-300 mm²
- Seti i kokave vendoset dhe hiqet shpejt
- Te kete markim CE

Te dhena teknike te setit te kokave

DARE matje multimeter (matje rryme ,tensioni,rezistence)

Ilustrimi

(Ilustrimi eshte orientues)



- Pajisja duhet të ketë ekran dixhital dhe hapje të dares deri në 42mm.
- Të ofrojë matjen e saktësi të lartë, përgjigje të shpejte ne ekran.
- Te jetë në gjëndje të detektojë presence tensioni, rezistence.
- Duhet të jetë e shoqëruar me aksesorë përmbajtjen e dares si dhe fishat përkatës të nevojshme për testime të ndryshme,

Specifikimet teknike:

- Dara e përshtatshme përpërcjellës deri në 42 mm
- Matje rryme AC deri në 1000 A me saktësi±2%
- Matje tensioni AC /DC deri ne 750V AC /1000V DC me saktësi±0,8%
- Mundësi matje me saktësi dhe në kushte me zhurma elektrike
- Matjes te saktë të rrymës AC në diapazonin 20-200-1000A me saktësi±2 %
- Matje te diodave
- Matje te rezistences se kontaktit me buzzer te vazhdueshem
- Matje rezistence nga 200-2K Ω m me saktësi±1.0%
- Dara ka butonin hold per ruajtje te dhenash dhe lehtesi ne matje
- Siguria Elektrike CATII 1000V /CATIII 600V sipas SSH EN61010

Dara duhet te kete markimin CE

Garancia 1 vit

SET ÇELËSASH FISO STELO

Ilustrimi

(Ilustrimi është orientues)



Pershkrimi

Seti i çelësave është i përbërë nga çelësa fiso dhe nga njëra anë dhe stelo në anën tjetër. Seti është i përbërë prej disa çelësave me përmasa ndryshme të afta për të përballuar nevojat e ndryshme në punimet elektrike si shtrengim, prerje etj. Çelësat do jenë të përbëra prej materiali 'Chrome- Vanadium steel', të afta për të përballuar forcat për të cilat janë projektuar.

Seti do jetë i përbërë nga çelësa me dimensione të ndryshme me përmasa metrike: 6 - 7 - 8 - 9 - 10 - 11 - 12 - 13 - 14 - 15 - 16 - 17 - 18 - 19 - 20 - 21 - 22 - 23 - 24 - 25 - 26 - 27 - 28 - 30 - 32mm

Paketimi

Cante plastike ose metalike

Marango manuale me zinxhir 3 ton

Ilustrimi

(Ilustrimi eshte orientues)



Pershkrimi

Karakteristika Teknike Parango manuale me zinxhire

- Parangua duhet te perballoje ngarkesen ne ngritje maksimumi deri ne 3 ton
- Te jete e pershtatshme per perdorim ne kabinat elektrike kryesisht te tipit murature por dhe ne kantjere ndertimi .
- Te jete e pershtatshme per punime ne vende te hapura dhe te mbyllura ku ka mungese te energjise elektrike
- Te jete lehtesisht e manovrueshme
- Siguri ne pune dhe mirmbajtje minimale
- Jetegjatesi ne perdorim

Te dhena teknike

- Kapaciteti 3Ton
- Materiali Celik
- Te kete Markim CE
- Garancia 1 Vit

ELEKTRIK I EMERGJENCES I KARIKUESHEM

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrim:

Elektrike dore me karikim (rezistent ndaj ujit) jane projektuar per te siguruar relativisht nje drite te permbledhur per raste te ndryshme.

Elektriku duhet te jete i thjeshte, i forte i sigurt ne cdo kohe dhe ne cdo vend. Ai ka nje pako baterish DC 6V, 4Ah te karikueshme.

Elektriku i karikueshem pajiset edhe me adaptues AC dhe adoptues per karikim ne automjet.

Eshte projektuar per tu perdorur edhe ne kohe me shi.

Te dhena teknike

Elektrik i karikueshem me llampa LED

Numri i baterive	1
Koha e punes se baterise (ore)	15 ore (perafersisht)
Lloji i llampes	LED
Materiali i trupit	Plastik
Lloji i kycjes	Shtyp On/Off
Lentet	Polikarbonate

Materiali duhet te kete markim CE

Garancia 1 Vit

SERI ÇELËSASH EGZAGON

Ilustrimi

(Ilustrimi eshte orientues)



Pershkrimi

Seti i çelësave përfshin dy lloje të çelësave si më poshtë.

Seti i egzagon është i perbere prej disa çelësave me përmasa ndryshme te afta per te perballuar nevojat e ndryshme ne punimet elektrike si shtrengim, prerje etj.

Çelësat do jenë të përbëra prej materiali ‘Chrome-Vanadium steel’, te afta per te perballuar forcat per te cilat jane projektuar.

Seti do jetë i përbërë nga çelësa me dimensione të ndryshme me përmasa metrike: Hex 1.5, 2, 2.5, 3, 4, 5, 6, 8, 10 mm

Paketimi

Cante plastike

INDIKATOR TU

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Indikatorit TU shërben për identifikimin e pranisë së tensionit me metodën pa kontakt.

Te dhena teknike:

Kufinjte e tensionit 50 deri 1000V AC

Kufinjte e tensionit 100 deri 1000V AC

Frekuenca (50 – 60) Hz

Indikatorit duhet të plotësojë kërkesat e sigurisë për pajisjet elektrike për matjen, kontrollin dhe përdorimin laboratorik, sipas standartit: SSH EN 61010-1 ose ekuivalente .

Kategoria e matjes: Kat IV 1000V.

Izolimi: Dopolim Izolim

Te pergjithshme:

Burimi i ushqimit:	Bateri 2x1.5 V alkaline te tipit AAA
Tregues:	vizual LED dhe akustik
Treguesi LED me ndriçim te kuq:	Sensi i ciklit jokorekt
Treguesi LED me ndriçim te gjelber:	Sensi i ciklit korekt
Temperatura e punes:	- 10 °C — + 50 °C
Dimensionet ± 5 %	160x26x20 mm
Lloji i mbylljes	Shtyp butonin On/Off
Metoda e ndjeshmerise	Pa kontakt
Ndjeshmeria e kontrollit te qarqeve AC	duke filluar nga 12V
Perfshin	2 bateri AAA

Duhet te jene te perfshira ne paketim dhe Instruksionet

Testim vazhdimisht i bateritve dhe qarkut te integruar me nje tregues vizual periodik ndezje te dyfishte.

Materiali duhet te kete markim CE

Instrumenti duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Direktivës Europiane të Tensionit të Ulët 2014/35/EU dhe Direktivës për Përputhshmërinë Elektromagnetike 2014/30/EU.

Garancia 1 Vit

SET PINCASH

Ilustrimi

(Ilustrimi eshte orientues)



Pershkrimi

Pincat duhet te jene te afta per te perballuar nevojat e ndryshme ne punimet elektrike si shtrengim, prerje etje. Ato jane prej çeliku vanadium krom, te afta per te perballuar forcat per te cilat jane projektuar.

Pinca duhet te jete shtrenguese 9"

Duhet te kene markim CE

SET kaçavida elektrike

Ilustrimi

(Ilustrimi eshte orientues)



Seti i kaçavidave do jetë një set i kompletuar me disa lloje kaçavidash. Kaçavidat do jenë prej materiali molybdenum-vanadium steel.

Të gjitha veglat përbërëse të setit duhet të jenë të izoluara për tensioni 1000V AC dhe duhet ta kenë të stampuar në trup nivelin e izolacionit prej 1000V AC sipas standartit VDE për izolimin dielektrik të paisjeve.

Seti i veglave përmban:

- Kaçavida të drejta të izoluara në gjithë gjatësinë (-) 1kV AC, 'ISLS' me material 'chromium-molybdenum-vanadium steel' me përmasa si në tabelë
- Kaçavida forme (+) të izoluara në gjithë gjatësinë 1kV AC 'ISLS' me material 'chromium-molybdenum-vanadium steel' me përmasa si mëposhtë.

Kaçavidë e drejtë

	Gjatësia totale mm	Gjerësia e majës mm	Trashësia e majës
Kaçavidë e drejtë	80	3	0.5
Kaçavidë e drejtë	125	5.5	1
Kaçavidë e drejtë	150	6.5	1.2

Kaçavidë formë plus +

	Gjatësia totale mm	Gjerësia e majës mm	Trashësia e majës
Kaçavidë formë plus +	PH0*75		
Kaçavidë formë plus +	PH1*75		
Kaçavidë formë plus +	PH2*100		

Ilustrimi



Seti i kacavidave mekanike permban :

Kacavide e drejte SL6*38 cope 1

Kacavide e drejte SL 5*75 cope 1

Kacavide e drejte SL 6*100 cope 1

Kacavide Kryq PH1*7 cope 1

Kacavide Kryq PH2*38 cope 1

Kacavide Kryq PH2*100 cope 1

Kacavidat duhet te jene prej materiali Krom-Vanadium CRV me veshje dy komponenteshe Per punim te lehte dhe kunder rreshqitjes. Kacavidat duhet te jene magnetike.

Seti gjithashtu duhet te permbaje nje komplet majash kacavidash kryq dhe te drejta se bashku me dorezen e punes:

35 cope ylleza CR-V 6.3x25, 3-4-5-6-7 PH0

PH1x3, PH2X5, PH3X3, PZ0, PZ1PZ2X2, PZ3X2, T10, T15, T20, T27, T30T40H2H3H4H5H6PCS, 35MM ¼ DR SOCKET, 456789101112

1COPE 4-6

1COPE 6,3 X139MM BAR

DRYN BRONZI I GJATE

Ilustrimi

(Ilustrimi eshte orientues)



Pershkrimi

Dryna bronzi te gjate per dyer kabinash dhe bokset kolektive duhet te kene keto karakteristika:

- Te jete pershtatshem per mbylljen e dyerve te kabinave elektrike ,bokseve dhe kasetave te shperndarjes
- Pershtatja dhe perdorimi ne te gjitha ambientet ne varesi te permasave te tyre
- Te prodhuar nga material rezistent kryesisht Celik ne pjesen e harkut

Te dhena teknike

- Niveli i sigurise 6
- Materiali i trupit Bronz
- Materiali i harkut Celik i trajtuar ne disa faza
- Permasat 40mm
- Numri i celsave 3

SEPATA

Ilustrimi

(ilustrimi dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrimi dhe aplikimi

Sepatat jene prej celiku te trajtuar dhe sherbejne per te prere apo care dru. Bishti eshte dru natyral. Siperfaqja e sheshte perfundon me buze te mprehta dhe te forta. Fundi eshte i sheshte. Ne koke ka biren paralele me siperfaqen e sheshte, per vendosjen e bishtit.

Te dhena teknike

Materiali : Celik karboni nr 45#, i farketuar, me fund

Pesha : 1000g

Tehu i sepates: Tehu eshte i farketuar dhe i trajtuar, me byze te mprehta dhe te lemuara, HRC46_52.

Bishti: Dru natyral i trajtuar dhe i forte, me buze te rumbullakosura.

Gjatesia e bishtit: Per peshe 1000g gjatesia e bishtit 430mm, ose sipas kerkeses

Mushama Shiu 100% PVC

Ilustrimi

(Ilustrimi eshte orientues)



Pershk:

Mushamaja e Shiut ka keto karakteristika kryesore:

- E prodhuar nga nje material PVC i padeptueshem nga uji
- Te mundesojne perdorim ne pune gjate rreshjeve me intesitet te larte

- Te jene te rehatshme ne perdorim gjate punes
- Te kete nje peshe sa me te lehte per te qene e peshtatshme gjate punes
- Te mundesoje ajrosje per te mos mbajtur nxehtesine gjate punes

Te dhena teknike

- Materiali PVC
- Permasat 115x78
- Ngjyra e Verdhe
- Pesha 350g/m²

Këto specifikime teknike janë të nevojshme për të garantuar që veglat e punës të jenë cilësore, të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdorim nga punonjësit e terrenit në përditshmërinë e punës së tyre.

Specifikimet teknike përshkruajnë tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, të cilat garantojnë cilësinë e kërkuar dhe përputhshmërinë e plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Specifikimet teknike janë hartuar nga një grup i posaçëm pune, i caktuar me urdhër të brendshëm dhe i përbërë nga inxhinierë të OSSH sh.a, Drejtoria Rajonale Berat.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se hartimi i specifikimeve teknike është kryer në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik dhe i shërben realizimit me sukses dhe në kohë të kontratës, duke garantuar përmbushjen e nevojave dhe kërkesave të institucionit.

Mosplotësimi i specifikimeve teknike si më sipër cituar nga ana e operatorëve ekonomik ofertues, do të çoj në skualifikimin e operatorit ekonomik.

NJËSIA E PROKURIMIT